

DOKUMENT POZICIONIMI: RINDËRTIMI I QYTETIT PAS KRIZËS - VETËRIPËRTËRITJA (*RESILIENCE*) URBANE PAS TËRMETIT

Universiteti POLIS | Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit | A.U.A - Unioni Shqiptar i Arkitektëve, Urbanistëve dhe Planifikuesve

I. HYRJE

Ngjarjet e fund-nëntorit 2019 mishëruan një krizë të paralajmëruar sa i përket sigurisë dhe cilësisë së planifikimit, ndërtimit, administrimit dhe qeverisjes të territorit/qyteteve në të gjitha hallkat dhe dimensionet në Shqipëri. Kjo krizë madhore dëshmoi **dështim në në qytetbërje, pavarësisht punës së bërë në disa sektorë apo drejtime**. Po ashtu ka dalë në pah fakti i mungesës së përgatitjes së mirëfilltë për të përballuar, parandaluar, apo zbutur efektet e ktastrafave, apo kriza madhore me karakter shkatërrues. Në këtë moment, ende në **kushte të emergjencës**, është e natyrshme që energjia dhe vëmendja të fokusohen në adresimin e fazës së parë të krizës. **Por, nga ana tjetër**, është e rëndësishme që të fillojmë të nxjerrim mësim për të ardhmen; të ndërgjegjësohemi për mënyrën se si duhet të planifikojmë dhe mbi të gjitha se si duhet të zhvillojmë territorin në Shqipëri; dhe të ndërmarrim **në këtë moment** veprime që do të adresojnë parandalimin, zbutjen dhe menaxhimin e krizave në periudhën afatgjatë. Pra, **është e rëndësishme që njëkohësisht me urgjencën, të nisim një proces analize dhe reflektimi të thellë parapërgatitës për krizat e të ardhshmes**.

Kjo ngjarje është edhe **një akt paralajmërues** i natyrës për fenomenet që priten të vijnë si rrjedhojë e ndryshimeve klimatike. Raportet ndërkombëtare dhe raportet e Ndryshimeve Klimatike të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, tregojnë qartë se vendi ynë do të preket ndjeshëm nga ky fenomen. Rrjedhimisht, katastrofat natyrore do të jenë jo vetëm më të shpeshta, por edhe shumë-dimensionale dhe/ose të kombinuara në impaktin e tyre në territor si: stuhi, përmytje, zjarre dhe rrëshqitje. Këto kriza, përtej përtej efekteve fizike, do të reflektohen në kriza sociale të lidhura me terrorizmin, migrimin masiv, ose luftra, apo edhe kriza të rënda ekonomike. E gjithë kjo kërkon **përgatitje serioze** dhe krijim të mekanizmave që garantojnë aftësinë vetëripërtëritëse të territorit dhe qeverisjes së tij në vendin tonë. Është e rëndësishme që të bëhet një dallim midis resilience në lidhje me ndryshimet klimatike dhe resilience për fenomenet sizmike. Por, ndërkohë, masat për secilin rast janë të ndërlidhura dhe të varura nga njëra-tjetra, e si rrjedhojë nuk duhet të trajtohen të izoluar.

International Symposium

"Today's Challenges of Construction Industry and Resilience to Natural Hazards"

Më 6 dhjetor 2019, Universiteti POLIS – Fakulteti i Arkitekturës dhe Inxhinierisë, Co-PLAN dhe A.U.A me mbështetjen e Ambasadës së Japonisë, organizuan forumin shkencor dhe sensibilizues me temë "Sfidat e Industrisë së Ndërtimit dhe Resilience (Aftësia Vetëripërtëritëse) ndaj Katastrofave Natyrore". Ky aktivitet ditor, solli bashkë profesionistë dhe teknikë, shkencëtarë, akademikë, specialistë të institucioneve publike, median, studentë dhe përfaqësues të shoqërisë civile, që diskutuan çështjet e zhvillimit të qytetit, sfidën e ndërtimit dhe të rindërtimit në Shqipëri në kuadër të dy ngjarjeve sizmike të shtatorit dhe nëntorit 2019, të cilat patën pasoja të konsiderueshme në jetë njerëzish, dëme ekonomike dhe sociale. Në këtë forum tekniko-shkencor kontribuan ekspertë të universitetit Universitetit POLIS dhe Co-PLAN, ekspertë nga Universiteti Politeknik i Tiranës, Instituti IGJEUM dhe Bashkia e Tiranës, ekspertë të pavarur dhe aktivistë të qytetit. Një grup ekspertësh nga Japonia dhe Zelanda e Re sollën eksperiencën e vendeve të tyre në përballimin e katastrofave natyrore, përgjigjen post-krizë dhe rikuperimin e shoqërisë dhe qytetit, dhe veçanërisht përgatitjen dhe planifikimin e rindërtimit resilient të qytetit, për t'i paraprirë krizave të ardhshme.

Çështja e rindërtimit të qytetit post-krizë dhe *resilient* në Shqipëri është mjaft komplekse dhe kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, të integruar dhe transparente. Në mënyrë që qytetet të performojnë me sukses dhe njerëzit të ndihen të sigurt është e nevojshme të planifikojmë duke pasur në fokus objektivin e *resilience*. Kjo vlen si për proceset e planifikimit në tërësi, ashtu edhe për rindërtimin post-krizë, e çfarëdolloji qoftë kriza.

Koncepti i *resilience* [urbane] është diskutuar shumë kohët e fundit në rangje shkencore e profesionale, dhe ka një dakordësi të përgjithshme që do të jetë një teori dominuese në vijueshmërinë e qeverisjes dhe zhvillimit të territorit. Edhe pse mbetet ende një koncept disi i ri, dhe është i ndryshëm nga konceptet e qëndrueshmërisë, apo të vulnerabilitetit, ndonëse i lidhur me to. Po ashtu, *resilience* duhet kontekstualizuar në bazë të karakteristikave territoriale e socio-ekonomike të vendit. Si rezultat i ndryshimeve ligjore në fushën e planifikimit në dekadën e fundit, është punuar për ta futur këtë koncept në planifikim dhe zhvillim territori, sidomos përmes VSM-ve të Planeve të Përgjithshme (Vendore e Kombëtare). Mirëpo vërehet një mungesë kuptimi dhe kontekstualizimi, veçanërisht në zbatim, ku në disa raste konsiderohet si diçka teorike e cila është jashtë realitetit dhe e vështirë për t'u zbatuar, e në disa raste të tjera neglizhohet tërësisht. **Pikërisht këtu qëndron gabimi:** nuk është kuptuar se që të planifikosh dhe ndërtosh për *resilience* nuk është jashtë realitetit, është domosdoshmëri dhe kërkon kapacitete, njohuri dhe përkushtim, si dhe financa. Nuk është një projekt, por një proces i vazhdueshëm dhe jetik.

Për konceptin e **urban resilience** (aftësisë vetëripërtëritëse urbane), siç u përmend dhe më sipër, nuk ka një përkufizim të unifikuar, por lejohet përshtatje në bazë të kontekstit. Ndaj, duke pranuar faktin se **urban resilience ka një kuptim shumë të gjerë, dhe varet edhe nga lloji i krizës**, (tërmet, përmytje, zjarr, veprimtari terroriste, lufta, falimentim financiar apo ekonomik, etj.) mund të thuhet se **është: “Kapaciteti ose aftësia e sistemit urban, përfshirë atë infrastrukturor dhe natyror me të cilin është i ndërlidhur, si edhe ndërveprimin social brenda tij, për t'i bërë ballë streseve të jashtme, krizave e katastrofave; për t'u ripërshtatur pas krizës, sa më shpejt dhe me mirë nga sa ishte para krizës; dhe për pasojë për të arritur një gjendje të re ekuilibri fizik, natyror, social-ekonomik dhe institucional. Është një ekuilibër i ndryshëm nga ai para krizës, por është një balancë e re e shëndetshme, dhe që arrihet shpejt”.**

Kur jetojmë situata relativisht normale, të përditshmërisë, pra pa kriza, ne harrojmë që **krizat dhe rreziqet shkatërrimtare ndodhen pas dere**. Ato nuk ndodhin përditë, nuk parashikohen dhe kanë karakteristika lokale, por efekti që kanë kur ndodhin shtrihet në një shkallë gjeografike shumë të gjerë, zgjat për shumë kohë, dhe prek thuajse të gjithë shoqërinë. **Pra, përgatitja jonë (*preparedness*) në nivel komunitar dhe institucional duhet të vijoje në mënyrë të përditshme**, në mënyrë që në momentin që ndodh një krizë, ne të jemi të përgatitur si nga pikëpamja institucionale dhe ajo komunitare për të dhënë një zgjidhje sistematike, si në përgjigjen immediate dhe urgjente, ashtu dhe në atë afat-mesëm e afat-gjatë të rindërtimit. Të qenit i përgatitur, do të thotë që të kesh një sistem të ngritur në shumë nivele. Në fjalë të tjera, është e nevojshme një **përgatitje institucionale, financiare dhe psiko-sociale**, ku qytetarët edukohen në vazhdimësi mbi të jetuarit dhe të përballuarit e krizave.

II. ANALIZA DHE SUGJERIME TË FAKTORËVE NDIKUES NË SEKTORIN URBAN PËR RRITJEN E *RESILIENCE*

Çfarë nevojitet të bëjmë në Shqipëri pas ngjarjes tragjike të nëntorit 2019 që të mund të themi se po planifikojmë, zhvillojmë apo ndërtojmë duke pasur në fokus objektivin e qytetit resilient, apo *urban resilience*?

Në rastin konkret në Shqipëri ne kemi marrë goditje të sistemit nga një katastrofë natyrore që është **tërmeti dhe flasin për *resilience* në planifikim, apo *urban resilience* në kushtet e kësaj krize.** Çfarë mund të kishim bërë ndryshe dhe çfarë mund të bëjmë ndryshe. Më poshtë, parashtrohen diskutimet dhe konkluzionet kryesore të simpoziumit, si një kontribut modest në hapat që mund të ndiqen tani dhe në të ardhmen në lidhje me menaxhimin e fatkeqësive natyrore dhe krijimin e **qyteteve, shoqërisë e qeverisjes resilient në Shqipëri.** Si pjesë e këtij realiteti, mendojmë se kemi nevojë si shoqëri, që të ndërmarrim hapa të tillë në të gjitha hallkat, nga ato institucionale dhe deri në nivel individual e komunitar.

Së pari planet kombëtare dhe vendore të territorit sugjerohet që të analizohen, dhe të plotësohen (aty ku është e nevojshme) duke shtuar elemente të *resilience*. Gjithsesi, kjo nuk anashkalon faktin që duhen hartuar **plane lokale e kombëtare për menaxhimin e krizave.** Këto plane duhet të jenë instrumente të ndryshme, por të lidhur fort me njëri-tjetrin; përforcues të njëri-tjetrit, madje edhe me përmbajtje përsëritëse për të garantuar që janë të koordinuar.

Problemi i dytë lidhet me informacionin dhe aksesin publik të tij:

1. Në 30 vitet e fundit, planet që janë bërë kanë marrë në konsideratë **hartat a rajonizimit dhe të rrezikut sizmik**, për shkak të detyrimit ligjor, për të zhvilluar zonimin e planit, por edhe si rrjedhojë e përgjegjësisë morale e profesionale të profesionistëve. Të dyja janë harta zonimi në nivel makro dhe jo mikro dhe të dyja të papërditësuara zyrtarisht që prej të paktën 40 vitesh. Janë konservatore mjaftueshëm në shifrat që japin, për të qenë të përdorshme edhe sot, por në kaq shumë vite, zonimi ka ndryshuar, çka e vërteton krahasimi mes tyre dhe hartës së realizuar në vitin 2015 në nivel Ballkani perëndimor. Për më tepër, planifikuesit kanë vite që përdorin hartat e realizuara në fillim të viteve '80të, pasi harta e vitit 2003 dhe ajo e vitit 2015, nuk kanë qenë të aksesueshme publikisht dhe/ose zyrtarisht. Po ashtu, ka qenë gjithmonë e nevojshme, në disa momente edhe detyrim ligjor, për të pasur mikrozonomin sizmik, i cili nuk ka qenë dhe ende nuk është i aksesueshëm.

2. Në mënyrë të njëjtë, **hartat gjeologjike dhe hidrogeologjike dhe hartat e rrezeve**, në rastin më të mirë janë në shkallën 1:100,000. Ato përfshihen në studimet e qarkulluara vetëm para 5 viteve, të hartuara në nivel qarku, të cilat u përgatitën në bazë projekti dhe iu ofruan qarqeve, por nuk u bënë asnjëherë publike në masë të gjerë. Për më tepër, janë harta të papërditësuar, pra janë thjesht informacion i vjetër i ofruar në mënyrë të re dhe në një shkallë të pamjaftueshme për planifikimin vendor dhe atë të detajuar, edhe pse planifikuesit i kanë përdorur.

3. Në Shqipëri nuk prodhohet informacion për **metabolizmin e qytetit dhe për shërbimet e ekosistemit**. Për shembull, nuk ka informacion për burimet ujore dhe rolin e tyre në sistemin urban. Pra nuk ka informacion ku dhe si përdoret uji për të gjitha llojet e funksioneve, çfarë sasive dhe cilësie uji del nga sistemi, si mbetje apo i pastër, si dhe ku shkon. Nuk mund të vlerësojmë dhe nuk kuantifikojmë dot, jo se nuk dimë teknikisht, por sepse nuk ka informacion të gjeneruar rregullisht dhe sistematikisht për këtë qëllim, se sa kapacitet ka për shembull parku i liqenit, Lana, dhe parku Rinia që të mbrojnë Tiranën nga përmbytjet e shirave lokale, apo stinore. Nuk ka informacion të përditësuar për përbërjen e tokave – njohuria për këtë çështje është në bagazhin e inxhinierëve të vjetër, por nuk ofrohet institucionalisht.

Pasi informacioni i mësipërm të sigurohet, të përditësohet dhe të krijohet edhe për nivele mikro, qytetarët dhe projektuesit e ndërtuesit duhet të pajisen me **hartën që klasifikon zonat sipas ndërtueshmërisë**, përfshirë parime apo standard teknike që duhet të zbatohen në çdo zonë. Sot, në Shqipëri, të aksesosh publikisht informacion teknik, shkencor dhe sasior, përveçse kur e gjeneron vetë, është shumë e vështirë. **Informacioni vazhdon të mbetet i kufizuar në një dorë të ngushtë ekspertësh, edhe pse me ligj duhet të jetë publik**. Institutet gjysëm të pavarura, të cilat zotërojnë dhe prodhojnë këtë informacion, duhet të garantojnë që ky informacion të jetë publik, pasi cilësia dhe akses i tij garanton jetët njerëzore. Një institut i aftë, kryen edhe veprimtarinë publike dhe atë private, pa përdorur njërën në kurriz të tjetrës. Për më tepër, ndoshta është momenti për të rishikuar skemën e funksionimit të disa institucioneve të tilla, të cilat nuk mund të mbijetojnë duke gjeneruar të ardhura nga dhënia e informacionit për qëllime publike e për këtë arsye, ndoshta, duhet të marrin financim të plotë publik. Kjo do të garantojë **eliminimin e monopolit** të krijuar aktualisht mbi informacionin. Informacioni është e mirë publike dhe mbështetja e shkencës me fonde të përshtatshme dhe me informacion, është një ndër hallkat kryesore për përgatitjen, planifikimin dhe ngritjen e sistemeve urbane resiliente. Për këtë qëllim, **rritja e fondeve deri në 5% të GDP do të ishte një hap përpara në kërkimin shkencor**, duke bërë realitet atë që për momentin ka mbetur një spekulim politik e elektoral. Gjithashtu, është e rëndësishme, dhe sugjerohet, që materiali shkencor, i përgatitur me financa publike, pa diskriminuar midis institucioneve publike e private, **duhet të jetë i aksesueshëm për të gjithë** dhe pa pagesë, veçanërisht për qëllime të cilat lidhen me interesin publik, si hartimi i planeve dhe siguria e qyteteve.

Problematika e tretë lidhet me analizat dhe propozimet në plane, të cilat kanë/duhet të kenë në fokus *resilience* urbane, si për shembull ato për **infrastrukturën, ndërtesat, hapësirat publike dhe hapësirat e pandërtuara në tërësi, aftësinë e komunitetit për t'u përshtatur dhe aftësinë e institucioneve për të qeverisur një moment krize dhe post-krize**. Këto analiza e propozime, aktualisht kanë qenë të vakëta në drejtim të *resilience* në tërësi, dhe në lidhje me ngjarje para dhe post-sizmike në veçanti. Kjo vjen si pasojë e mungesë së informacionit, e faktit se koncepti është i ri, apo njohuritë teknike në këtë drejtim kanë qenë të pamjaftueshme. Por, mbi të gjitha vjen si pasojë e vendimmarrjeve që kanë favorizuar zhvillimin intensiv përkundrejt sigurisë, nën presionin tepër të lartë për të ndërtuar, pavarësisht kushteve të terrenit apo të zhvillimit në një zonë të caktuar. Gjithashtu, kjo vjen edhe si rrjedhojë e mungesës së një metodologjie të unifikuar dhe dakordësuar për harmonizimin e këtyre aspekteve.

Kjo problematike, zgjerohet edhe më tej në standardet e planifikimit. Këto ditë është folur shumë për Eurokodet dhe normat teknike të projektimit. Është fakt, që kemi norma të vjetëruara dhe ndërkohë nuk kemi kontekstualizuar dhe përvetësuar institucionalisht Eurokodet në ndërtim. Në këtë kuptim, jemi në vakum ligjor projektimi dhe ndërtimi sa i përket cilësisë dhe sigurisë. Padyshim, këto janë shumë të rëndësishme dhe lidhen drejtpërdrejt me katastrofën që ndodhi.

Por, për të parandaluar një katastrofë të dytë, **veçsa më sipër, duhet që një orë e më parë të hartojmë standardet e planifikimit.** Ka pasur përpjekje në këtë drejtim, por nuk është konkluduar me një akt ligjor. Zbatimi i standardeve të planifikimit në Shqipëri nuk ishte i thjeshtë – pasi tingëllonte jo realiste të mendoje për sipërfaqe parcele për kopshte apo çerdhe, distanca midis objekteve, koeficientë për hapësira publike e të gjelbra, etj në kushte e tranzicionit socio-ekonomik që vendi ka qënë dhe vazhdon të kalojë. Në këtë tranzicion janë keqkuptuar të drejtat e pronësisë, të cilat janë konsideruar si të drejta absolute mbi pronën. Si rezultat, tregu i pasurive të patundshme ka qënë burim fitimesh me marzhe të larta në krahasim me vendet e tjera të Evropës, ku pronarët kanë kërkuar dhe vazhdojnë të marrin nga zhvillimi mbi 30% të vlerës së tij, ndërkohë që zhvilluesit kërkojnë të marrin mbi marzhin prej 12-20% që realizohet në Evropë. Këto çështje, të kombinuara dhe me korrupsionin e sistemit ligjor dhe administrativ në dhëniet e lejeve të ndërtimit rëndojnë faturën financiare të zhvillimit dhe efektin e saj mbi qytetarët dhe jetueshmërinë në qytet. Ky është momenti për një reflektim të thellë dhe për të vepruar ndryshe. Eksperienca botërore ka treguar, që përtej ndërtesës, fatalitetet më të mëdha në raste krizash, shkaktohen nga qyteti i zhvilluar në kundërshtim me standardet që garantojnë jetueshmëri dhe mungesa e infrastrukturës së përshtatshme mbështetëse.

Një element jashtëzakonisht i rëndësishëm për *urban resilience*, që lidhet dhe me standardet e planifikimit dhe me gjithë procesin e lejeve dhe të menaxhimit të tokës është **hapësira publike, hapësira e hapur (jo e ndërtuar) dhe infrastruktura rrugore. Hapësira** pa ndërtim, siç e qujmë ndryshe, është **“thembra e Akilit”** për të menaxhuar veçanërisht momentin gjatë krizës dhe fazën emergjente. Hapësira publike dhe pa ndërtim, përveçse një e mirë kolektive në aspektin e jetueshmërisë së qytetit, **është hapësira e parë e evakuimit në rast krize.** Në Durrës, apo edhe në Tiranë, njerëzit në shumicën e rasteve u detyruan të qëndronin poshtë pallateve, të pasigurt, në mungesë të hapësirës publike. Në Tiranë, shumë njerëz shkuan tek Parku i Liqenit, si një nga hapësirat e pakta pa ndërtesa, por në kundërshtim me rregullat e sjelljes gjatë tërmetit, sipas të cilave nuk mund të qëndrohet në afërsi të pemëve apo në një digë. Pra është e rëndësishme që të kuptohet, se hapësira publike, përtej të mirave estetike e mjedisore, ka dhe një rol të rëndësishëm në sigurinë publike. Është një fakt i njohur që në qytetet tona, si rrjedhojë e densifikimit, janë humbur shumë hapësira të lira, apo dhe për qëllime sportive, si rasti i fushave të futbollit. Mirëpo, kjo ishte zgjidhja e vetme në mungesë të shesheve, ku njerëzit do të mund të streheshin përkohësisht, deri sa të kalonin pasgoditjet e para, ku mund të mbroheshin nga objektet e mundshme që binin nga ndërtesat, dhe të mbanin të lira rrugët për evakuim dhe trajtim të urgjencave.

Ne, sot, kemi përcaktime ligjore për hapësirën publike, për rrugët, sheshet dhe parqet. Kemi edhe një **VKM të dedikuar për hapësirën publike.** Veçanërisht kjo VKM nuk është përdorur *de facto* nga aktorët zbatues, sepse propozon instrumente tregu që garantojnë hapësirën e nevojshme publike dhe, të cilat, që të zbatohen kërkojnë më tepër energji dhe përfshirje, si nga bashkia, ashtu edhe nga zhvilluesit. Propozimet e kësaj VKM-je kanë ardhur në bazë të eksperiencave botërore, dhe mund të përmirësohen më tej. Por, jemi ne që si shoqëri duhet të ndërgjegjësohemi që e **mira kolektive në lidhje me hapësirën publike, në fakt është e mirë individuale,** sepse në kohë të vështira si këto që po kalojmë, të gjithë prekemi, si pronari i pallatit apo i parcelës, si zhvilluesi apo ndërtuesi, ashtu edhe banorët që blejnë, dhe po ashtu bashkia që ka rolin të harmonizojë interesat e të gjithëve. Mbi 10 fusha futbollit e 90% e hapësirës së hapur që trashëguam pas 1990-ës është ndërtuar dhe qyteti ka vetëm ndërtesa e rrugë të ngushta. Pra në vend që të injorojmë bazën ligjore, që e kemi, duhet të shohim si ta zbatojmë dhe rrugës edhe ta përmirësojmë, jo për të lehtësuar punën e aktorëve, por për të zgjidhur më mirë problemet që synon të adresojë baza ligjore – nevojën për hapësirë publike.

Qartësisht, rindërtimi i qytetit duhet të fillojë të konsiderojë seriozisht krijimin e hapësirës publike, jo vetëm në nivel qyteti por për çdo njësi urbane, bllok apo lagje. Mirëpo, kjo nuk mund të ndodhë në emergjencë, me vendime “ad-hoc”, por në mënyrë të mirëmenëduar dhe duke ofruar një qasje të integruar dhe që zbatohet me ritëm intensiv. **Duhet patur kujdes edhe që të lidhim krizat me njëra-tjetrën.** Për shembull, një park urban në tokë me aluvione, mund të jetë zgjidhje për situatat post-tërmet, por jo për të përballuar përmytjet. Ndërkohë, njerëzit nuk mund të lëvizin drejt pyllit në rast tërmeti, por në rast ndryshimesh klimatike pylli është shpëtimi. **Pra zgjidhjet nuk zëvendësojnë dot njëra-tjetrën** dhe *resilience* sizmike duhet parë ngushtësisht me atë të ndryshimeve klimatike.

Rindërtimi i lagjeve të reja në vijim duhet të marrë në konsideratë cilësinë e tokës dhe të krijojë hapësirën publike. Sigurisht na duhen banesa të reja, por duhet të vlerësojmë se ku do të ndërtohen për të shmangur që pas 20 apo 30 viteve, **kur të përsëritet cikli sizmik, të jetë krijuar oazi i krizës së re. Ne kemi nevojë për lagje të qëndrueshme e të sigurta** dhe ndërtime të qëndrueshme, të përshtatura me karakteristikat e tokës dhe gjeologjisë, dhe me hapësira publike. **Na duhen studime urgjente dhe cilësore para se të ndërtojmë, sepse kostot që janë krijuar e do të krijohen do t'i mbartë shoqëria jonë, sot dhe në periudhën afatgjatë.**

Një element tjetër i rëndësishëm i *resilience* urbane është i lidhur me çështjet sociale. Përzjerja e funksioneve në qytet dhe shmangja e getoizimit, geto të varfra apo të pasura qofshin, është një domosdoshmëri. Segregimi urban është faktor përkeqësues në post-krizë. Mos të harrojmë se kemi të bëjmë me njerëz, me komunitete, me shtresa të ndryshme shoqërore, ndarja e të cilave dhe trajtimi i pabarabartë vetëm thellon krizën sociale. Në këtë rast, është e rëndësishme që të shihen, analizohen dhe merren në konsideratë, me studime fizibiliteti, zgjidhje të ndryshme të cilat janë të vlefshme për të zgjidhur problemin e strehimit. Këto zgjidhje mund të variojnë nga përdorimi i stokut ekzistues të banesave përmes politikave sociale, ndërtimi i lagjeve të reja me banesa sociale, apo dhe reflektimi mbi taksat e pronësisë dhe akumulimi i tyre, etj. Gjithsesi, sugjerojmë që të tregohet kujdes jo vetëm në aspektin fizik dhe financiar të zgjidhjes, por dhe në atë social e psikologjik. Është e rëndësishme që për të zgjidhur një çështje të mos shkatërrojmë komunitete dhe të mos krijojmë kosto të padrejta për shoqërinë.

Elementi tjetër që lidhet me **hapësirën publike janë distancat (midis ndërtesave, midis ndërtesave dhe infrastrukturës, dhe midis ndërtesave e kufinjve pronësore).** Historikisht dhe deri vonë, në Shqipëri, distancat i janë nënshtruar zvogëlimit konstant të tyre. Hapësirat e ngushta bëjnë që njerëzit të mos evakuhohen, të mos lëvizin lirshëm, si dhe vështirësojnë aksesin e ambulancave e zjarrfikëseve. **Sot ka pallate të ndërtuara shumë mirë e të padëmtuara që rrezikohen nga pallate të shpalluara të pabanueshme ngjitur me to.** Në këto kushte duhet menduar jo si të ngushtojmë ende distancat, por si t'i rritim. Pra në vend që të shikojmë për zgjidhje (edhe ekstraligjore) që të zvogëlojmë distancat për të rritur fitimin, duhet të ndërgjegjësohemi që këto janë të nevojshme dhe duhen rritur.

Elementi i tretë për hapësirën publike është **infrastruktura dhe hapësirat e pandërtuara në tërësi.** Së pari kemi nevojë për **rrugë të gjera për evakuim dhe mbrojtje gjatë krizës.** Rruga e drejtë është element i evakuimit të shpejtë. Në qytetin organik (historik) nuk e garantojmë dot, por në qytetin e ri, me ndërtesa të larta banimi dhe biznesi është domosdoshmëri. **Po ashtu, territori urban ka nevojë për rrjet rrugor që mbulon tërë hapësirën, dhe aty ku është e mundur duhet të jetë ortogonal. Çdo ndërtesë duhet të ketë akses në rrjet dhe rrjeti duhet të respektojë parimin e hierarkisë.**

Akresi në infrastrukturë, u dëshmuar dhe në tërmetin e 21 shtatorit, ku njerëzit dolën të çoroditur e në panik nga qendra tregtare në autostradë; shumë prej tyre aq konfuzë sa vrapuan të merrnin makinat në garazhin e qendrës, për të krijuar një bllokim trafiku prej 5 kilometrash deri në hyrjen e Tiranës. Shumë prej tyre, të mbetur në trafik, pritën poshtë kablllove dhe shtyllave të tensionit të lartë – një tjetër hapësirë e rrezikshme në evakuim. Në këtë situatë, përtej problemit infrastrukturor, kemi të bëjmë dhe me **një problem kulturor dhe institucional**. Në Shqipëri **njerëzit janë të papërgatitur edhe në nivel individual** për mënyrën se si mund të menaxhojnë një krizë të tillë. Por, **qartësisht problemi infrastrukturor që çon në pamundësi evakuimi, duhet adresuar në mënyrë kritike**. Një sistem *resilient* urban ka nevojë për rrjet rrugor të përbërë nga arterie, autostrada dhe rrugë lokale, **sikurse e përcakton kodi rrugor, me distancat dhe parametrat e kodit rrugor**; i aksesueshëm nga çdo ndërtesë dhe me rrugë alternative. Teknikisht kjo e fundit njihet si **koncepti i redundancy në infrastrukturën rrugore**. Por nga ana tjetër duhet të tregojmë kujdes, pasi kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht më shumë betonizim rrugor, që është e rrezikshme për *resilience* ndaj përmbytjeve dhe ndryshimeve klimatike. Sot ekziston teknologjia për të ndërtuar rrugë të filtrueshme dhe poroze. Kjo vlen për hapësirat e parkimit dhe për të gjithë rrjetin e lëvizjes, sidomos në zonat e hapura rekreative, në parqe, etj.

Për të adresuar të gjitha pikat e dobëta dhe për të ndërtuar një sistem *resilient*, ne kemi nevojë për **mirëfunksionimin e dy vektorëve të përhershëm: i) përgatitje për përballim krize; ii) qeverisje dhe planifikim *resilient***.

Vektori 1: Përgatitje dhe përballim krize

Edukim dhe trajnim të shoqërisë për t'u parapërgatitur psikologjikisht dhe praktikisht.

Përgatitje e strukturave publike dhe jo publike të ndërhyrjes sipas një strategjie afatgjatë dhe në përmirësim të vazhdueshëm.

Përballim i goditjes së krizës së radhës, dhe përgjigje emergjente bazuar në parimin "zero dëme në njerëz".

Zbatimi i masave të planit, financimi post-krizë dhe materialet/paisjet emergjente për veprimet gjatë krizës.

Donacionet, vullnetarizmi dhe koordinimi i ndihmës për të përballuar me eficiencë gjendjen e emergjencës.

Tejkalimi i krizës, trajtim i efekteve psikologjike, nxjerrje e mësimave të reja, përditësim i planeve dhe strategjive të masave të ndërhyrjes.

Përgatitja për krizën e radhës ...

Vektori 2: Qeverisje dhe planifikim *resilient*

Survejim i fenomenit, grumbullim të dhënash para dhe pas, dhe projeksione paralajmëruese për fenomene të tjera dhe për efektet afatmesme dhe afatgjata.

Rivlerësim i bazës ligjore, i planifikimit, projektimit, zhvillimit, dhe zbatim i masave të reja.

Rishikim i procesit dhe bazës ligjore dhe përgjegjësi për: dhënien e lejeve, zbatimin, monitorimin, supervizionin, kolaudim dhe çertifikimin.

Rivlerësim i ndërtesave, çertifikim i strukturave dhe sigurisë, shfrytëzim dhe mirëmbajtje ciklike.

Nxjerrje e ndërtesave të monitoruara jashtë shfrytëzimi kur është e nevojshme, krijim i hapësirës publike dhe rrizhvim i përgjegjshëm dhe i qëndrueshëm në zona të tjera.

Sigurim strehimi social të sigurt, strehim emergjent, sigurim i ndërtesave.

Vlerësim i dëmit dhe *resilience* pas çdo krize dhe rishikim i sistemit ligjor e institucional në parapërgatitje për të ardhmen.

III. KONKLUSIONE

Për të plotësuar dy vektorët, aspektet e rëndësishme të *resilience urbane* dhe planifikimi e rindërtimi me këtë koncept në fokus në Shqipëri përmbledhen si vijon:

***Resilience* në teknologjitë, cilësinë dhe sigurinë në ndërtim e strehim**

1. Sugjerohet të krijohet një **metodologji kombëtare mbi vlerësimin, përforcimin** dhe meremetimin / rehabilitimin e strukturave të dëmtuara nga tërmeti. Kjo metodologji mund të unifikohet dhe duhet të zbatohet me rigorozitet, gjetjet e vlerësimit të jenë transparente dhe mbi bazën e tyre të merren vendime të rindërtimit.
2. Është e nevojshme, në mënyrë urgjente, të kryhet **vlerësimi inxhinierik i qëndrueshmërisë dhe cilësisë së strukturave**, jo vetëm në qytete, dhe jo vetëm në zonat e dëmtuara, **por edhe në zonat informale dhe rurale**. Në këto zona ndërtimet janë realizuar në mënyrë të pavarur nga njerëzit dhe pa projekt, pra siguria e tyre është e panjohur dhe e diskutueshme. Legjislacioni i legalizimit përmban përcaktime të tilla, por kanë qenë të anashkaluara, ndërkohë që analiza para legalizimit nuk është kryer e plotë.
3. **Nisur nga eksperiencia ndërkombëtare, dhe veçanërisht ajo e Zelandës së Re, rekomandohet të ngrihet një sistem kombëtar dhe lokal monitorimi për ndërtesat** në lidhje me **përformancën dhe amortizimin** e tyre dhe mbi këtë bazë të krijohen politika strehimi. Ky sistem duhet të jetë transparent dhe i aksesueshëm nga të gjithë. Kjo **bazë të dhënash kombëtare, e krijuar mbi të dhënat strukturore të ndërtesave**, të dhëna sizmike e gjeofizike të truallit, do t' u shërbejë jo vetëm specialistëve të ndërtimit, por edhe qytetarëve. Informacioni duhet të jetë i hapur dhe i aksesueshëm nga të gjithë. Është e nevojshme që kjo databazë, të shërbejë si një lloj certifikimi inxhinieriko-strukturor që informon qytetarët për cilësinë e banesave dhe sigurinë që ato ofrojnë. Përtej monitorimit, sistemi duhet të mbështetet me masa institucionale dhe financiare, të cilat çojnë në përmirësimin e situatës dhe reduktimin e rrezikshmërisë nga ndërtesat problematike. Gjithashtu, veçanërisht për institucione publike dhe private, të cilat akomodojnë për kohë të gjata një numër të konsiderueshëm përdoruesish, duhet një sistem monitorimi shumë herë më i detajuar. Është shumë e nevojshme, që një instrument i tillë, si ngritja e databazës, të shmanjë mundësitë e spekulimit në tregun e pasurive të patundshme, e për këtë arsye, duhet parë si një instrument informues që i lë qytetarëve vendimmarrjen për qasjen ndaj banesave. Në rast të ndërtesave të cilat është e nevojshme të prishen, hapësira e krijuar duhet të përdoret si hapësirë e lirë publike.

4. Nga simpoziumi ndërkombëtar *"Today's challenges of construction industry and resilience to natural hazards"* një ndër shqetësimet kryesore, lidhej me bazën ligjore **mbi kodet e projektimit dhe ndërtimit dhe anekset kombëtare**, e cila duhet të plotësohet në mënyrë urgjente, **dhe e bazuar në një diskutim të gjerë e transparent institucionalo-profesional**. Ndërsa kjo bazë ligjore duhet bazuar tek Eurokodet, duhet edhe të përshtatet për karakteristika të veçanta të territorit në Shqipëri.

5. Është e nevojshme që të **përforcohen kontrollet teknike profesionale gjatë të gjithë ciklit të ndërtimit deri në lëshimin e certifikatës së përdorimit**, me **fokus në entitetin publik** dhe duke korrigjuar çdo formë korruptimi. Nga pikëpamja ligjore, detyrimi i bashkisë për sistemin e supervizionit, kontrollit, kolaudit dhe përfundimisht certifikimit duhet të vijë i plotë dhe i qartë, duke eliminuar çdo ambiguitet e mbivendosje që sot lejon një status të mjegullt. Përtej një sensibilizimi për sektorin privat që ushtron një sërë detyrimesh gjatë të gjitha hapave të ndërtimit, **bashkitë kanë plotësisht përgjegjësinë ligjore të sigurisë së qytetarëve** dhe duhet ta garantojnë atë në të gjitha hapat e miratimit të projektit dhe të zbatimit e certifikimit. Nëse për të realizuar funksionin e saj bashkia ka nevojë për më shumë specialistë, atëherë duhet të bashkëpunohet me institutin e ndërtimit, apo çdo strukturë teknike publike të krijuar enkas. Gjithashtu, dokumentacioni përkatës duhet të jetë i aksesueshëm online për të gjithë qytetarët.

6. Në kuadrin e ndryshimeve ligjore dhe masave për rritjen e sigurisë, është e nevojshme që të shihen dhe skema të ndryshme të sigurimit të ndërtesave. Skemat duhet të vendosin nivele që reflektojnë aftësinë paguese të shoqërisë.

Zgjedhjet private janë të natyrës individuale.

Planifikimi *resilient* dhe qeverisja

1. **Duhet bërë ndryshimet dhe përmirësimet ligjore**, të cilat u analizuan më sipër, **veçanërisht përsa i përket standardeve të planifikimit dhe reflektimit të resilience në plane**, e mbi të gjitha duhen ngritur **mekanizma zbatimi e monitorimi**.
2. **Informacioni gjeoteknik, hidrogeologjik, sizmik, i llojit të tokave, rreziqeve natyrore, duhet të jetë i përditësuar, i aksesueshëm në kohë reale për institucionet dhe ekspertët, dhe online i vlefshëm për të gjithë njerëzit**. Ne operojmë sot në kushtet e mungesës dhe papërgjegjshmërisë informative dhe mungesa e aksesit në informacion krijon monopole që rrezikojnë jetën e njerëzve. Çdokush, ka të drejtë të dijë nëse nëntoka e zonës së tij ka një thyerje tektonike, ka rrezik rrëshqitjeje, ka përmbajtje të lartë radoni, apo të tjera si këto.
3. Kemi nevojë për një **vlerësim të dëmit social-ekonomik**, jo thjesht vlera aktuale e dëmit dhe kosto e rindërtimit, **por vlera e dëmit që vjen nga efekti domino** – bankat që kanë dhënë kreditë, bizneset që u prishën, papunësia e krijuar, pamundësia e shumë familjeve për të çuar fëmijët në shkollë këtë vit, ngarkesa me taksa e atyre që janë në sistem dhe rritja e numrit të atyre që janë jashtë sistemit, e kështu me radhë. **Këtu nuk ka vend për panik, por për mendim racional, teknik dhe hapa të matura** në vendimmarrje. **Vlerësimet dhe një strategji e mirë e bazuar mbi to, do na mundësojnë**, midis të tjerash, aksesimin e fondeve **për rizhvillim dhe absorbimin e mirë të tyre**.
4. **Duhet të kthejmë vëmendjen nga zhvillimi rajonal**. Gjithmonë e kemi nënvlerësuar dhe anashkaluar. **Kur ndodhi kriza njerëzit e gjetën zgjidhjen kudo veçse në Tiranë dhe në Durrës**. Me mënyrën se si kemi zhvilluar, përqëndrimi i popullsisë, aktivitetëve ekonomike, dhe tendencave për rritjen e migrimit drejt këtij rajoni, i cili është me rrezikshmëri të lartë sizmike vetëm sa shton probabilitetin e dëmeve më të mëdha në raste të katastrofave të tjera. Kjo vlen edhe për një pjesë të ultësirës perëndimore, dhe jo vetëm për ngjarje sizmike. Nëse i referohemi parashikimeve të ndikimeve në territorin e Shqipërisë, ato do të kenë impaktin më të madh pikërisht në këtë rajon. Pra është e nevojshme që të kuptojmë se duhet një qasje e mirëmenduar për zhvillimin rajonal. Rritja e resilience e Shqipërisë, por dhe zhvillimi i qëndrueshëm në tërësi, nuk duhen përqendruar vetëm në Tiranë-Durrës. Resilience dhe zhvillim i qëndrueshëm arrihen duke marrë në konsideratë të gjithë territorin, dhe duke rritur mundësitë e shfrytëzimit të potencialeve të çdo rajoni.
5. Së fundi, duhet analizojmë në mënyrë të thelluar **planet, të hartojmë planet e menaxhimit të katastrofave dhe emergjencave**, me objektivin dhe fokusin për resilience. Në nivel ndërkombëtar, ka metodologji të mirëpërcaktuara në këtë aspekt. Ato duhet të kuptohen e më pas të kontekstualizohen. Në këtë kuadër, **bashkitë nuk ka pse të presin nga qeveria qendrore**, por të bëhen proaktive për territoret e tyre, të krijojnë **linja buxheti, të aplikojnë për fonde**, dhe të veprojnë. Duhet të funksionojë decentralizimi dhe bashkitë të marrin përgjegjësi reale edhe në menaxhimin e krizave, pa pritur gjithçka vetëm nga niveli qendror.

6. Duhet të fillojë të veprojë **zbatimi i ligjit të bashkëpronësisë**. Këtu ka nevojë për **ndërgjegjësim të shoqërisë**. Banorët tani kanë përpara vetes një rast konkret për t'u bërë të vetdijshëm. Një pjesë e rrezikut në ndërtesa vjen nga amortizimi i tyre dhe mungesa e mirëmbajtjes.
7. Duhet **ndalur me shfrytëzimin e gjithë parcelës për ndërtim**. Duhet të **zbatohen koeficientët e shfrytëzimit të tokës dhe të krijohen hapësirat publike e të rriten distancat**. Në këtë rast, akti ligjor për hapësirat publike, duhet të marrë vëmendje kryesore e të fillojë të zbatohet, të përmirësohet (aty ku është e nevojshme) e të monitorohet në zbatim. Duhet të promovojmë praktika të mira të krijimit të hapësirave publike, e t'i kthejmë ato në praktika të përditshmërisë së zhvillimit urban.
8. Qytetet në Shqipëri duhet të pajisen **urgjentisht me facilitete për strehim dhe grumbullim në raste krizash**, pavarësisht nga lloji i krizës. Duhet parë se cilat janë krizat që mund të prekin territore të ndryshme dhe mbi këtë bazë të veprohet.
9. **Qytetet tona kanë nevojë për sisteme alarmi**. Dikur i kemi patur, edhe pse me një tjetër qasje, por këto sisteme janë shumë të vlefshme. Qytetet jo vetëm duhet të pajisen me sisteme të tilla, por ato duhet të mirëmbahen, e qytetarët të trajnohen me simulime sistematike.
10. **Kemi nevojë që çdo bashki të krijojë Ekipet Vullnetare të Përgjigjes së Shpejtë**, të cilat duhet të trajnohen dhe të trajnojnë bashkëqytetarët e tyre se si të veprojnë në raste zjarresh, përmytjesh, tërmetesh, e kriza të tjera. Qytetarët duhet të pajisen me informacion dhe të marrin kulturën bazë për këtë qëllim.

Duhet të kuptojmë, se *resilience* nuk është vetëm një koncept teknik dhe që kërkon vetëm qasje me ndërhyrje fizike në territor. Është e qartë, nga gjithë diskutimi i simpoziumit, nga problematikat e trajtuara dhe nga zgjidhjet e ofruara, se pa një “qeverisje resilient”, pa institucione resilient, shumë prej këtyre propozimeve do jenë të vështira për t'u arritur. Është e rëndësishme, që kjo krizë, të shërbejë për të ridimensionuar mentalitetin tonë qeverisës, duke rritur pjesëmarrjen e qytetarëve në qeverisje, dhe duke krijuar sisteme, të cilat janë të afta të vetëripërtërihen në kohë krize.

Në përfundim, ajo që ndodhi në fund-nëntorin e 2019-ës, tregon se në Shqipëri kemi shumë për të bërë; në Shqipëri nuk ka dështuar racionaliteti individual, edhe pse njohuritë individuale shumë herë të kufizuara na kanë bërë të marrim vendime personale të gabuara. Ajo që ka dështuar është racionaliteti shoqëror, garancia institucionale për publikun, si dhe sistemi rregullator i interesave të përbashkëta apo kolektive. Dhe pikërisht nga këtu duhet të fillojmë të veprojmë për rindërtimin e qytetit post-krizë dhe për ripërtëritjen e shoqërisë.



© Të gjitha të drejtat rezervuar autorëve: Universiteti POLIS, Co-PLAN,
Instituti për Zhvillimin e Habitatit, A.U.A - Unioni Shqiptar i Arkitektëve,
Urbanistëve dhe Planifikuesve
Dhjetor 2019